REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| Pranuar / Dorëzuar / Primljeno/Predato / Received/Delivery | 11. 12. 2018 | viti / god / year |
|---|---|---|
| Organi/Njësia / Organ/Jedinica / Org./Unit | Nr. i Prot. / Br. Prot. / Prot. No. | Shtojca / Prilog / Appendix | Sasia / Količina / Quantity |
| SKPMSHCK | 7582/2018 | | 1/3 |

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

---

Nr. 366 /2018
Datë: 05.12.2018

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nënparagrafit 1.2 dhe nenit 19 paragrafëve: 1, 5 nënparagrafit 5.1, 6 dhe 8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi shqyrtoi raportin me rekomandimin e Anëtarit të Këshillit për mbikëqyrjen e procedurës së rekrutimit për pozitën Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ultë "Lekë Dukagjini" në Komunën e Prizrenit, Këshilli në mbledhjen e njëzet e pestë (XXV) të mbajtur më datë 05.12.2018 mori këtë:

## VENDIM

I. **APROVOHET si e rregullt** procedura e rekrutimit për pozitën Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ultë "Lekë Dukagjini" në Komunën e Prizrenit, sepse është zhvilluar në pajtim me dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 08/2014 Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendësdrejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues.

II. **OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Prizrenit, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë zbatimin e tij, si dhe të njëjtin t'ua dërgoj kandidatëve në procedurë të rekrutimit në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim për zbatimin e këtij vendimi.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

## Arsyetim

1. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 26.07.2018 nëpërmjet shkresës me numër protokolli 4337/2018 është njoftuar nga Komuna e Prizrenit, që më datë 25.07.2018 ka shpall konkursin e jashtëm për pozitën Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ultë "Lekë Dukagjini", duke u bazuar në dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, respektivisht shkresës së aprovimit për autorizim të shpalljes së jashtme të lëshuar nga Ministria e Administratës Publike/Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil të datës 25.07.2018.

2. Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 26.07.2018 merr Vendimin me numër V.nr.301/2018 me të cilin bënë emërimin e Kolegjit lidhur me vëzhgimin e procedurës së rekrutimit për pozitën Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ultë "Lekë Dukagjini" në Komunën e Prizrenit.

3. Këshilli, ka konstatuar se kriteret dhe kushtet e përcaktuara në konkursin e shpallur për pozitën Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ultë "Lekë Dukagjini" në Komunën e Prizrenit, kanë qenë:
   - *Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;*
   - *Të ketë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimi prej 240 ECTS/ 4 vite të shkollimit universitar), nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore;*
   - *Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit ose të jetë në procedurë të licencimit;*
   - *Të ketë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim dhe menaxhim e noterizuar ose e vërtetuar*
   - *Të kenë se paku 3 vjet përvojë pune në arsim ose në institucion të arsimit.*

4. Këshilli, ka konstatuar se Komuna e Prizrenit, me datë 17.10.2018 ka përcjell tërë materialin e zhvillimit të procedurës së rekrutimit. Anëtari i Këshillit për mbikëqyrje, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit ka konstatuar se Kryetari i Komunës së Prizrenit, me datë 10.08.2018 ka nxjerr Vendimin me numër Nr.01/060-121459 për themelimin e Komisionit Rekrutues prej tre (3) anëtarëve, me këtë përbërje:
   1. *Zana Saramari-Kryetare*
   2. *Vildane Vllasaliu Zena-anëtare*
   3. *Alban Bytyqi-anetar.*

5. Këshilli, ka konstatuar se në bazë të Formularit "E" si vëzhgues të procesit kanë marr pjesë edhe dy (2) anëtar të Këshillit të Shkollës/Prindërve.

6. Këshilli, gjatë shqyrtimi të dokumentacionit të ofruar ka konstatuar se për Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ultë "Lekë Dukagjini" në Komunën e Prizrenit, kanë aplikuar dhjetë (10) kandidatë si në vijim:
   1. *Salajdin Hoxhaj;*
   2. *Abdullah Hoxha;*
   3. *Anila Berisha;*
   4. *Enkelejda Gashi;*
   5. *Hysamedin Beshi;*
   6. *Shqipe Kastratri;*
   7. *Vezire Berisha;*
   8. *Arafat Gasghi;*
   9. *Adem Morina dhe*
   10. *Xhelal Dervishaj.*

7. Këshilli, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar, është konstatuar që për këtë procedurë ka mungesë të dokumentacionit dhe më datë 23.11.2018 kemi kërkuar me e-mail zyrtar prova shtesë nga Komuna e Prizrenit, ndërsa provat janë sjell më datë 26.11.2018.

8. Këshilli, ka konstatuar se komisioni rekrutues ka shqyrtuar aplikacionet e kandidatëve dhe në bazë të Formularit **"C"** në listën e shkurtër ka përfshirë të gjithë kandidatët, të cilët kanë plotësuar kushtet në bazë

të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.08/2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendësdrejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues.

9. Këshilli, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit ka konstatuar, se testimi me gojë i kandidatëve është mbajtur me datë 29.08.2018, dhe kanë marrë pjesë shtatë (7) kandidatë si ne vijim: *Salajdin Hoxhaj, Abdullah Hoxha, Xhelal Dervishaj, Enkelejda Gashi, Shqipe Kastrati, Anila Berisha dhe Vezire Berisha* ndërsa kandidatët si *Adem Morina, Arafat Gashi dhe Hysamedin Beshi* nuk kanë marrë pjesë në testin me gojë.

10. Këshilli, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar nga Komuna e Prizrenit, ka konstatuar që komisioni rekrutues për vendin e punës Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ultë "Lekë Dukagjini" në Komunën e Prizrenit, ka rekomanduar kandidatin **Salajdin Hoxhaj**, i cili posedon:

- **Diplomën** me Nr.146 të datës 04.01.2013 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, me të cilën dëshmohet se më datë 22.05.2012 ka përfunduar programin për aftësim dhe rikualifikim (ARK) duke marr titullin Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe me 240 kredi.
- **Licencën** e mësimdhënësit me Nr. 100012516 të lëshuar nga MASHT me datë 01.03.2013.
- **Certifikatën** e lëshuar në shkurt 2018 nga OJQ Kosova Hope për përfundimin e programit "Ndërtimi i kapaciteteve të drejtorëve të shkollave për udhëheqje arsimore 168 orë".
- **Përvoja e punës të kandidatit të përzgjedhur:** në bazë të vërtetimit me Nr. 51/2018 të datës 07.08.2018 ka gjithsejtë 32 vite përvojë pune në SHFMU "Lekë Dukagjini".

11. Bazuar në nenin 19 paragrafin 4 dhe 5 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Anëtari i Këshilli për mbikëqyrje ka paraqitur raportin me rekomandimin që të aprovohet si e rregullt procedura e rekrutimit për pozitën Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ultë "Lekë Dukagjini" në Komunën e Prizrenit.

12. Këshilli në mbledhjen e mbajtur me datën 05.12.2018 pasi shqyrtoj raportin e paraqitur nga Anëtari i Këshillit për mbikëqyrje, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

13. Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës, Kryetari i Këshillit dhe personat kompetent i ndërmarrin veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

***Këshillë juridike:*** *Vendimi i Këshillit për procedurën e përzgjedhjes së nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, është vendim përfundimtar në procedurë administrative dhe kundër këtij vendimi palët në procedurë kanë të drejtë të iniciojnë konflikt administrativ, në pajtim me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit.*

**Vendimi i dërgohet:**

- *Anëtarëve të Këshillit;*
- *Kryetarit të Komunës së Prizrenit; dhe*
- *Arkivit të Këshillit.*

**Eshref SHABANI**

**Kryetar i Këshillit**